



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
06.11.2024**

Me datë 06.11.2024, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqejza, Edmond Ndou, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Gezim Galiqi, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Irena Shala, Artan Haxhi, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Gjenarin Kapcari, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Suada Kopshti, Marina Duhani, Erkan Hoxha, Vjoleta Përndrecaj, Ardita Spahija, Gloria Shllaku, Gjovalin Ndoj, Samed Bushati, Fatmir Vojvoda, Anita Amuli, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Jetmira Rraboshta.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2024".*
2. Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55, datë 29.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër" të ndryshuar.*
3. Pr/ Vendim: *"Për caktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe në sheshe, në territorin e Bashkisë Shkodër".*
4. Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim në VKB Nr.8 datë 31.01.2024, Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Shkodër për "Projektin Hold On- nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë".*
5. Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim dhe shtesë në VKB Nr.5 dt:05.01.2022 "Për miratimin e rrjetit të linjave dhe tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve për periudhën afatmesme 2022-2024 në Bashkinë Shkodër"*
6. Pr/ Vendim: *"Për saktësim dhe përditësimin e të dhënave të pjesshme të VKK Postribë nr.13 datë 09.06.2005 "Miratimi i inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Postribë" miratuar me VKM-në nr.477 datë 29.06.2011 "Për miratimin e*

listës përfundimtare të pronave të paluajtshe publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës së Postribës, Qarkut Shkodër", për pasurinë me nr.33/7 Qendra Shëndetësore Mes dhe për pasurinë me nr.33/6, Komuna Postribë".

7. Pr/ Vendim: "Për miratimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit publik, në territorin e Bashkisë Shkodër".
8. Pr/ Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.18 dt.20.07.2024 "Për miratimin e dhënies me qira/përdorim të sipërfaqes 0.320 ha në Ekonominë Pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A.Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse, aerogjeneratorë për një periudhë 12 muaj për shoqërinë "Volitalia ALBANIE"
9. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Z.Luli sqaron se ka një kërkesë për shtim të një pr/vendimi në rendin e ditës dhe një kërkesë për heqje të pikës 3 nga rendi i ditës. konkretisht Pr/ Vendim: "Për caktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe në sheshe, në territorin e Bashkisë Shkodër".

Vijohet me rendin e ditës. Lidhur me pr/vendimet për 6% e ndihmës ekonomike vlerësohet nga këshilltarët e pranishëm që nuk ka nevojë për relativitet dhe të hidhen në votim së bashku.

Para se të kalohet me votimin e tyre **Z.Bjanku** kërkon të dijë nëse mund të rritet tranferta e kushtëzuar prej 6% e ndihmës ekonomike?

Përgjigjet **Z.Malocaj**, drejtor drejtorie i Ndihmës ekonomike duke thënë se është e përcaktuar me ligj tranferta e kushtëzuar deri në 6% dhe nuk mund të ndryshohet.

Pr/vendimi i parw hidhet në votim: Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2024", ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Hidhet në votim :Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Tetor 2024, ku rezultojnë **39** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 2 të rendit të ditës: Pr/ Vendim: "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55, datë 29.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër" të ndryshuar.

Relaton për këtë pr/vendim **Znj. Haxhi** drejtoreshë e përgjithshme e Menaxhimit dhe Kontrollit financiar, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, **Z.Ndou** shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD **Z.Sokoli** po ashtu shprehet dakort, kurse **Znj.Shala** nga kualicioni BF dhe **Z.Shllaku** nga PD janë kundër Pr/vendimit për arsye se këto efekte financiare që u përmendën nuk vijnë vetëm nga rritja e pagave por edhe nga shtimi i numrit të punonjësve.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **27** vota Pro, **9** Kundër,**1** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën e rradhës së rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim në VKB Nr.8 datë 31.01.2024, Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Shkodër për "Projektin Hold On- nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë".*

Relaton për këtë pr/vendim **Znj.** Kruja drejtoreshë e drejtorisë së Shërbimit social dhe strehimit, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Shala merr fjalën dhe kërkon të dijë nëse është përzgjedhur kandidati për këtë pozicion, pasi na është thënë se për punën më kohë të pjesshme nuk ka patur kandidatë, kurse me kohë të plotë thuhet në relacion që fillimi i punës është data 1 tetor? Gjithashtu Znj.Shala kërkon që t'i vihet në dispozicion e-maili i dakordësisë.

Përgjigjet **Znj.Kruja** duke thënë se përzgjedhja është bërë tashmë dhe se kërkesa për kohë të plotë duhet për të rritur/përmirësuar objektivat e projektit. Po ashtu mund t'iua vëmë në dispozicion çdo shkresë që kërkon në çdo kohë.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **28** vota Pro, **11** Kundër,**0**Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pr/vendimin e rradhës: Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim dhe shtesë në VKB Nr.5 dt:05.01.2022 "Për miratimin e rrjetit të linjave dhe tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve për periudhën afatmesme 2022-2024 në Bashkinë Shkodër"*

Relaton për këtë pikë Zv/Kryetari i Bashkisë **Z.Bejleri**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bashi merr fjalën duke përgëzuar fillimisht stafin e Bashkisë Shkodër për punën, po ashtu kërkon të dijë a janë vendosur tabela dhe a është e mundur të vendoset një autobus shtesë për turistët?

Përgjigjet **Z.Bejleri** duke thënë se është menduar çdo gjë e nevojshme dhe përsa i përket autobuzit duhet parë dhe vlerësuar mundësia.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **39** vota Pro, **0** Kundër, **0**Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën e rradhës: Pr/ Vendim:*"Për saktësim dhe përditësimin e të dhënave të pjesshme të VKK Postrisë nr.13 datë 09.06.2005 "Miratimi i inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Postrisë" miratuar me VKM-në nr.477 datë 29.06.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshe publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës së Postrisë, Qarkut Shkodër", për pasurinë me nr.33/7 Qendra Shëndetësore Mes dhe për pasurinë me nr.33/6, Komuna Postrisë".*

Relaton për këtë projekt vendim **Z.Preka**, drejtor i drejtorisë së Aseteve dhe Kadastrës, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje dhe diskutime nuk ka, pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 37 vota Pro. 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën tjetër të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit publik, në territorin e Bashkisë Shkodër ”.*

Fjalën e merr përsëri **Z.Bjanku**, i cili thotë se për procedurë kërkojmë heqjen e kësaj pike për arsye sepse ka disa aspekte që kanë nevojë të ndryshohen. Ai thotë se ka bërë edhe një kërkesë për shtyerjen e këtij pr/vendimi.

Ndërhyn **Z.Lesha** duke thënë se lidhur me kërkesën e Z.Bjanku jemi dakort si administratë për ta shtyrë në një moment të dytë duke qënë se paska paqartësi ose këndvështrim tjetër për rregulloren. Ne mirëpresim dhe vlerësojmë kontributin e Z.Bjanku, por kjo nuk duhet të shërbejë për të bërë politikë, sepse ky Pr/vendim është paraqitur që në korrik të këtij viti dhe ka kaluar në komisione dhe është bërë edhe dëgjese publike për të siç e kërkon ligji.

Kurse **Z.Sokoli** shprehet se nuk sheh të nevojshme që të shtyhet miratimi i këtij pr/vendimi.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro shtyerjes së Pr.Vendimit, edhe Znj.Shala nga kualicioni BF dhe Z.Shllaku nga PD janë pro shtyerjes së Pr/vendimit.

Shtyerja e miratimit të Pr/aktit hidhet në votim , ku rezultojnë 24 vota Pro. 7 Kundër,0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet tek pr/vendimi i rradhës së rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për një ndryshim në VKB nr.18 dt.20.07.2024 “Për miratimin e dhënies me qira/përdorim të sipërfaqes 0.320 ha në Ekonominë Pyjore “Pruemos Sheldi”, ngastra 104, Nj.A.Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse, aerogjeneratorë për një periudhë 12 muaj për shoqërinë “Volitalia ALBANIE”*

Relaton për këtë pr/akt **Znj.Aida Shllaku**, drejtoresha e drejtorisë së Mjedisit, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bjanku pyet nëse mund të ketë ndonjë fitim të munguar për Bashkinë meqënëse po flasim për shtyerje afati nga konpania? A ka ndonjë element ekonomik prej të cilit Bashkia Shkodër privohet nga fitimi në këtë rast nëse do vihej në funksion më përpara ky projekt?

Përgjigjet **Z.Bejleri** duke thënë se normalisht që shtyerja e projektit do afektojë në realizimin e tij dhe automatikisht edhe në efektet ekonomike por konpania ka kryer instalimet e nevojshme por kushtet nuk e kanë lejuar të kryejë një cikël të plotë për matjen e erës prandaj kërkojnë shtyrje me qëllim që studimi i tyre të jetë sa më i saktë.

Edhe **Znj.Shala** shprehet se meqënëse vonesat janë prej 4 muajsh pse nuk bëjmë shtyerje vetëm 4 muaj dhe 12 muaj.

Përsëri **Z.Bejleri** thotë se duhet bërë një cikël i plotë një vjeçar i pandërprerë në kushte dhe kohë të ndryshme atmosferike.

Znj.Pode merr fjalën dhe shton se kjo vjen edhe si pasojë e kushteve atmosferike, me të cilat përballemi vitet e fundit.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort, kurse Znj.Shala nga kualicioni BF dhe Z.Shllaku nga PD janë kundër Pr/vendimit.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **29** vota Pro, **10** Kundër, **0**Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e fundit të rendit të ditës: Diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr **Z.Mehmetaj** e cila sjell përsëri në vëmendje shqetësimin e banorëve të rrugës “Roza Lejn”, rrugë e cila ka nevojë emergjente për ndërhyrje.

Z.Duhani shprehet lidhur me sallat mortore, të cilat janë kthyer në shqetësim për banorët e pallateve, ku ushtrohet ky lloj biznesi. Ajo përsërit edhe njëherë shqetësimin lidhur me makinën që terheq mbeturinat në Gjuhadol, që kjo që është e papërshtatshme për rrugën në fjalë. Gjithashtu ajo shpreh ngushëllimet e saja për viktimat e ngjarjes së datës: 30.10.2024.

Fjalën e merr **Znj.Shllaku** e cila sjell në vëmendje disa investime të parashikuara në buxhetin e vitit 2024 për rajonin nr.5 por që nuk janë realizuar akoma. 1.Tek blloku i pallateve është parashikuar ndërhyrja tek rruga “Gjon Buzuku” dhe punimet s’kanë filluar. Banorët madje kanë paraqitur edhe një petition për këtë. Aq më tepër që te këto pallate ka edhe rënie të suvasë tek fasadat. 2. Duhet të kryhet edhe rivijëzimi pranë shkollës “Ndoc Mazi ” dhe është shumë e nevojshme në atë zonë për sigurinë. 3. Në këtë rajon nuk ka filluar akoma as puna për korsitë e biçikletave dhe as për kanalet KUZ dhe KUB. Akoma nuk asnjë investim në zonë. 4. Dhe në rrugët “Milan Shuflaj”, “Mehmet Shpendi” dhe “Vllaznimi” mungojnë koshat e mbeturinave.

Znj,Shkrela merr fjalën dhe kërkon për të disatën herë që Kryetari Bashkisë të jetë prezent në Mbledhjet e Këshillit aq më tepër që ka patur ngjarje e zhvillime në qytet. Para pak ditësh kryetari është thirrur në SPAK dhe sot duhet të ishte prezent të na sqaronte edhe arsyen pse është thirrur atje. As për ngjarjen me 4 viktima nuk shprehu as një qëndrim. Edhe në lidhje me pagesën e bursave të nxënësve të shkollave profesionale ajo kërkon të dijë pse nuk kanë kaluar pagesat. Po ashtu edhe përsa i përket sallave mortore që përmendi kolegja Znj.Duhani ndan të njëjtin shqetësim dhe kërkon të dijë pse nuk është marrë akoma asnjë masë. Kjo cënon edhe konkurrencën e ndershme të këtyre bizneseve.

Z.Bejleri shprehet se lidhur me sallat mortore shqetësimi është i drejtë dhe beson që në mbledhjen e ardhshme do keni një përgjigje për këtë bashkë me dokumentacionin përkatës.

Kurse **Znj.Haxhi** sqaron në lidhje me bursat se është kryer pagesa për nxënësit e shkollave të përgjithshme dhe shumë shpejt do bëhet edhe pagesa për shkollat profesionale, pasi bordorotë janë gati.

Znj.Shala shprehet se si grup politik kemi kërkuar informacion mbi ndriçimin e zonës muzeale të Gjuhadolit. Kemi kërkuar projektin dhe çdo dokumentacion lidhur me të. Ajo shton se mbesim në pritje të një përgjigjeje nga ana e Bashkisë nëse është kompetencë e saj në të kundërt të na tregohet kompetencë e kujt është. Po ashtu tjetër kërkesë e saj është edhe larja e rrugës së Gjuhadolit.

Z.Bejleri sqaron edhe njëherë lidhur me fasdat se mirmbajtja dhe merimetimi i tyre është përgjegjësi dhe detyrim bashkëpronarëve/banorëve. Megjithatë sipas mundësive do marrim masa për ndërhyrje.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka Z.Luli e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 06.11.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 7 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Sabina DANAJ



KRYETAR

Oltion LULI



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sallishti



Ogert Sokaku
okuzo